

RREGULLORE NR. 2000/20

UNMIK/REG/2000/20

12 prill 2000

MBI ADMINISTRATËN DHE PROCEDURAT TATIMORE

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet që i janë dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të ndryshuar, të datës 25 korrik 1999 mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë dhe Rregulloren nr. 1999/16 të UNMIK-ut, të ndryshuar, të datës 6 nëntor 1999 mbi Themelimin e Organit Qendror Fiskal dhe çështje të tjera lidhur me të,

Me qëllim të institucionalizimit të administratës dhe procedurave tatimore,

Shpall sa vijon:

Neni 1

PROCEDURAT TATIMORE

Bashkëkryesuesit e Organit Qendror Fiskal mund të lëshojnë udhëzime administrative mbi procedurat tatimore, duke përfshirë këtu veçmas procedurat vijuese:

- (a) detyrimin e tatimpaguesve për mbajtjen e librave dhe shënimeve që kanë të bëjnë me detyrimet e tyre tatimore;
- (b) detyrimin e tatimpaguesve për paraqitjen e fakteve të nevojshme për llogaritjen e detyrimeve të tyre tatimore;
- (c) procedurën për dorëzimin e deklaratës tatimore dhe deklaratave tatimore të korrigjuara;
- (d) afatet kohore dhe procedurat për pagimin e tatimit dhe
- (e) të drejtat e tatimpaguesve për përfaqësim.

Neni 2

KONTROLI FINACIAR DHE VLERËSIMI

Bashkëkryesuesit e Organit Qendror Fiskal mund të lëshojnë udhëzime administrative nga fushëveprimi i administratës tatimore për të:

- (a) inspektuar dhe kontrolluar llogaritë e tatimpaguesit ose të cilitdo person tjetër i cili mund të ofrojë të dhëna relevante që kanë të bëjnë me detyrimin tatimor të tatimpaguesit;
- (b) vlerësuar rastet kur tatimpaguesi nuk e ka dorëzuar deklaratën tatimore në përputhje me kërkesat ligjore ose kur administrata tatimore ka vërtetuar se tatimpaguesi ka dorëzuar deklaratë tatimore të pasaktë;
- (c) lëshuar një njoftim- vlerësim dhe kërkesë për pagim, bashkë me afatet kohore dhe procedurat e pagimit dhe
- (d) lëshuar kredi tatimore apo për të kthyer shumën e tatimit të paguar më tepër.

Neni 3

KAMATAT PËR PAGESAT E VONUARA

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative për caktimin e kamatave kur tatimpaguesi e paguan tatimin me vonesë.

Neni 4

MBLEDHJA E DHUNSHME E TATIMIT

4.1. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative për procedurat vijuese të mbledhjes me dhunë të tatimit për:

- (a) venien e tatimit në llogaritë e papaguara, në paga dhe llogari bankare;
- (b) marrjen e pasurisë dhe kufizimin e të drejtave pronësore të tatimpaguesit në pasurinë e tij
- (c) shitjen në ankande publike të pasurisë dhe
- (d) marrjen me gjyq të mjeteve nga personat e tretë, duke përfshirë bankat apo institucionet e tjera financiare.

4.2. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative të cilat saktësojnë pasurinë e cila duhet përjashtuar nga bllokimi, kufizimi dhe marrja.

Neni 5

SHKELJET TATIMORE DHE GJOBAT

5.1. Sipas kësaj rregulloreje, “shkelje tatimore” nënkuptohet një veprim apo mosveprim i tatimpaguesit apo i personit të autorizuar nga tatimpaguesi që bie ndesh me detyrimet e tatimpaguesit sipas kësaj rregulloreje apo rregulloreve të tjera që kanë të bëjnë me tatimin, me direktivat administrative të nxjerra në pajtim me to ose me udhëzimet administrative të lëshura nga bashkëkryesuesit e Organit Qendror Fiskal.

5.2. Mosdorëzimi i deklaratës tatimore brenda afatit të caktuar. Tatimpaguesi i cili nuk e dorëzon deklaratën tatimore ose e dorëzon pas afatit të caktuar, dënohet me gjobë në masën prej pesë për qind (5%) për tatimin e papaguar për çdo muaj apo pjesë të muajit për të cilin pagesa është vonuar. Gjoha maksimale e pagueshme është njëzet e pesë për qind (25%) nga shuma e detyrimit të papaguar.

5.3. Mospagimi i tatimit në kohën e caktuar. Tatimpaguesi i cili nuk paguan tatimin në kohën e caktuar detyrohet të paguajë gjobën prej dy për qind (2%) nga shuma e përgjithshme e tatimit të papaguar për secilin muaj apo pjesë të muajit për të cilin është vonuar pagesa, por jo më gjatë se dymbëdhjetë (12) muaj.

5.4. Tatimi i deklaruar më pak. Nëse tatimpaguesi nuk e ka deklaruar shumën e plotë të tatimit që është dashur ta paguajë, tatimpaguesi detyrohet të paguajë gjobën në masën prej pesëdhjetë për qind (50%) nga diferenca e shumës së tatimit që është dashur të deklarohet dhe shumës që aktualisht është deklaruar.

5.5 Fshehja e qëllimshme e tatimit. Kur tatimpaguesi e ka fshehur me qëllim detyrimin e tij tatimor ose ka bërë lajthitje të qëllimshme lidhur me këtë detyrim, tatimpaguesi detyrohet ta paguajë dënimin në masën prej njëqind për qind (100%) nga diferenca e shumës së tatimit që është dashur të deklarohet dhe shumës së tatimit që aktualisht është deklaruar.

5.6 Sulmi fizik ose kërcënimi ndaj zyrtarit tatimor. Administrata tatimore do t'i ndërmarrë të gjitha masat e mundshme civile dhe penale kundër atyre personave të cilët i sulmojnë apo i kërcenojnë zyrtarët tatimorë.

5.7 Shkeljet tjera dhe dënimet. Bashkëkryesuesit e Organit Qendror Fiskal mund të lëshojnë udhëzime administrative që të ngarkohen me gjobë mbi shkeljet tatimore, po qe se këto dënime nuk e kalojnë shumën prej 250 DEM.

Neni 6

KUFIZIMI I AFATEVE KOHORE

6.1. Administrata tatimore duhet të lëshojë një njoftim-vlerësim në afat prej tri (3) vitesh nga data kur tatimi duhet paguar. Në rastin kur tatimpaguesi nuk e dorëzon deklaratën tatimore brenda këtij afati ose ka dorëzuar deklaratë tatimore të rrejshme, njoftim-vlerësimi mund të lëshohet në çdo kohë.

6.2. Veprimet për pagimin me dhunë të tatimit mund të ndërmerren në afat prej gjashtë (6) vitesh nga data kur tatimi duhet paguar ose nga data e cilitdo vlerësim të bërë nga administrata tatimore, pavarësisht se cili veprim është i fundit. Me fillimin i procedurës gjyqësore për pagimin me dhunë të tatimit përfundon afati i përcaktuar kohor.

6.3. Tatimpaguesi ka të drejtë t'i dorëzojë administratës tatimore kërkesën për pranimin e shumës së paguar më tepër dhe kthimin e saj brenda një afati prej gjashtë (6) vitesh nga data kur tatimi është paguar.

Neni 7

ANKESAT

7.1 Sekori për shqyrtimin e ankesave: Tatimpaguesi i cili nuk është i kënaqur me përcaktimin e të hyrave të tij ose të bazës së tij tatimore, vlerësimin e gjobës së shqiptuar nga ana e administratës tatimore (më tej “vendimi zyrtar”) mund të kërkojë që Sektori për Shqyrtimin e Ankesave i Administratës Tatimore (më tej “Sektori për ankesa”) t’ia rishqyrtojë përcaktimin e tij tatimor.

7.2 Procedura e shqyrtimit. Kërkesa për shqyrtim bëhet me shkrim, e mbështetur me dëshmi të dokumentuara sipas dëshirës së tatimpaguesit. Kërkesa për shqyrtim bëhet brenda një afati prej 60 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit për përcaktimin zyrtar të tatimit.

7.3. Afati i njoftimit për vendim: Administrata tatimore e njofton me shkrim tatimpaguesin për vendimin e rishqyrtimit brenda një afati prej 30 ditësh pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim nga tatimpaguesi.

7.4. Udhëzimet administrative: Në pajtim me dispozitat e nenit 7 të kësaj Rregulloreje, bashkëkryesuesit e Organit Qendror Fiskal mund të lëshojnë udhëzime administrative lidhur me procedurat e kërkesave të shqyrtimit, të cilat tatimpaguesi dhe administrata tatimore duhet t’i përfillin, duke përfshirë këtu rrethanat kur tatimpaguesit mund t’i lejohet shtyrja e kohës deri kur ai duhet t’ia bëjë kërkesën për shqyrtim Sektorit të ankesave.

7.5. Vendimi përfundimtar i administratës tatimore. Për qëllimet e kësaj rregulloreje dhe çfarëdo instrumentesh tjera plotësuese të bëra pas këtij momenti, duke përfshirë këtu edhe mbledhjen me dhunë të tatimit, vendimi i Sektorit të ankesave është vendim përfundimtar i administratës tatimore.

7.6 Ankesa drejtuar bordit për rishqyrtim të pavarur. Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm e themelon Bordin për Shqyrtim të Pavarur (më tej “Bordi”) me udhëzim administrativ. Tatimpaguesi mund t’i ankohet bordit për ta rishqyrtuar vendimin

përfundimtar të administratës tatimore brenda një afati prej 60 ditësh pas marrjes së njoftimit për vendimin e Sektorit të ankesave. Ankesa bëhet me shkrim, e argumentuar me prova e faktike, sipas dëshirës së tatimpaguesit.

7.7. Shqyrtimi i ankesës. Bordi duhet ta shqyrtojë ankesën brenda një afati prej 60 ditësh nga dita e dorëzimit të ankesës. Tatimpaguesi dhe administrata tatimore, në procedurën e shqyrtimit të ankesës, mund t'i japin bordit prova plotësuese me shkrim ose me gojë. Bordi i njofton palët për vendimin e vet, bashkë me arsyetimet me shkrim, brenda një afati prej 30 ditësh pas përfundimit të procedurës së shqyrtimit.

7.8. Shqyrtimi nga ana e gjykatës. Tatimpaguesi ose administrata tatimore mund t'i drejtohen gjykatës kompetente që ta rishqyrtojë vendimin e bordit.

7.9. Detyra për të provuar të vërtetën. Tatimpaguesi e ka për detyrë të dëshmojë se tatimi i caktuar nga administrata tatimore është i gabuar.

7.10 Mospezullimi i detyrimit tatimor. Kërkesa e tatimpaguesit drejtuar Sektorit për ankesa që ta rishqyrtojë përcaktimin zyrtar të tatimit, ankesa drejtuar bordit apo kërkesa drejtuar gjykatës për rishqyrtim, të bëra në pajtim me nenin 7 të kësaj rregulloreje, nuk e pezullon detyrimin e tatimpaguesit për të paguar tatimin e vlerësuar.

7.11 Pezullimi i mbledhjes së tatimit me dhunë. Pavarësisht nga neni 7.10 i kësaj rregulloreje, tatimi nuk mund të mblihdet me dhunë derisa Sektori për pagesa mos ta ketë përfunduar shqyrtimin e kërkesës së tatimpaguesit, ose derisa administrata tatimore ta lëshojë vendimin përfundimtar në pajtim me nenin 7.5 të kësaj rregulloreje, ciladoqoftë procedura e fundit.

7.12. Pezullimi i shitjes së pasurisë së marrë. Pasuria e marrë nga administrata tatimore, në përputhje me kompetencat për mbledhjen e tatimit me dhunë, nuk mund të shitet apo të tjetërsohet për një periudhë prej së pakut 60 ditësh pas marrjes së pasurisë, ose gjatë shqyrtimit të çfarëdo procedure apo ankese të tatimpaguesit të paraparë me nenin 7 të kësaj rregulloreje, ciladoqoftë procedura e fundit.

7.13. Procedura pas përfundimit të çështjes: Në rastet kur më në fund procedura përfundon në favor të tatimpaguesit, administrata tatimore do t'ia kthejë tatimin e paguar më shumë, bashkë me interesin e krijuar deri në momentin e përfundimit të çështjes. Nëse në fund çështja përfundon në favor të administratës tatimore, tatimpaguesi detyrohet ta paguajë tatimin e papaguar, gjjobat dhe kamatën e krijuar në momentin e përfundimit të çështjes.

Neni 8

ZBATIMI

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë udhëzime administrative lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje.

Neni 9

LIGJI NË FUQI

Kjo rregullore shfuqizon çdo dispozitë tjetër të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të

Neni 10

HYRJA NË FUQI

Kjo rregullore hyn në fuqi më 12 prill 2000.

Bernard Kouchner,
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm